



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 23.05.2022
Dokument Parlamentar

RAPORT

Për shqyrtimin e kandidaturave për zgjedhjen e Presidentit të ri të Republikës së Shqipërisë, në votimin e raundit të dytë, datë 23 Maj 2022

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 87 dhe të nenit 88, pika 2/1 të Kushtetutës, në seancën plenare të datës 12.05.2022, njoftoi fillimin e procedurës parlamentare për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në vijim të Konferencës së Kryetarëve, e cila në mbledhjen e saj të datës 10.05.2022, me vendimin nr. 9, datë 10.05.2022, vendosi fillimin e procedurës parlamentare për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe caktimin e datës 16 maj 2022, ora 17.00, si datë e zhvillimit të raundit të parë të votimit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në zbatim të pikës 2 të nenit 109 të Rregullores së Kuvendit dhe Vendimit të Konferencës së Kryetarëve, shqyrton në një mbledhje të veçantë, plotësimin e kriterëve formale-juridike, të përcaktuara në nenin 86 dhe 87, pika 1 e Kushtetutës për kandidatin/kandidatët e mundshëm të propozuar për President të Republikës së Shqipërisë. Komisioni i paraqet raportin seancës plenare në respektim të rregullave ligjore.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, u mbledh më datë 16 maj 2022, ora 09.00, sipas përcaktimeve të Rregullores së Kuvendit. Komisioni konstatoi se deri në afatin e përcaktuar nga Konferenca e Kryetarëve, asnjë kandidaturë nuk është depozituar në Kuvendin e Shqipërisë.

Në këto kushte, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në zbatim të nenit 87, pika 2 të Kushtetutës, që përcakton se "*Votimi i parë zhvillohet jo më vonë se*

7 ditë nga fillimi i procedurës për zgjedhjen e Presidentit” dhe “Votimi quhet i kryer edhe kur në konkurrim nuk paraqitet asnjë kandidat”, i paraqiti seancës plenare të mbledhur më datë 16 maj 2022, ora 17.00, për informim raportin përkatës, me qëllim përmbylljen e procedurave për votimin e raundit të parë për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Kryetarja e Kuvendit Znj. Lindita Nikolla, pas shpërndarjes dhe njohjes së raportit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në seancën plenare të datës 16 maj 2022, për përmbylljen e procedurave për votimin e raundit të parë për zgjedhjen e Presidentit të Republikës, i cili rezultoi pa kandidatë, menjëherë pas zhvillimit të kësaj seance, në zbatim të nenit 87, pika 2 e Kushtetutës dhe nenit 109, pika 3 e Rregullores së Kuvendit e cila përcakton se: *Konferenca e Kryetarëve menjëherë cakton datën e kryerjes së votimit të dytë, i cili zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e votimit të parë për zgjedhjen e Presidentit të Republikës*, mblodhi Konferencën e Kryetarëve, në të cilën me anë të vendimit Nr. 11, datë 17.05.2022, u vendos caktimi i datës 23 maj 2022, ora 18.00, për zhvillimin e raundit të dytë të votimit për Presidentin e Republikës.

Konferenca e Kryetarëve, bazuar në pikën 3 të këtij vendimi, përcaktoi që Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të zhvillojë procedurën parlamentare për shqyrtimin e kandidaturës/kandidaturave më datë 23 maj 2022 në orën 10.00 dhe të paraqesë raportin e këtij Komisioni.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut u mblodh sot më datë 23 maj 2022, në orën 10.00, sipas përcaktimeve të Rregullores për shqyrtimin e kandidaturave të mundshme të depozituara në Kuvend.

Komisioni konstatoi se deri në afatin e përcaktuar nga Konferenca e Kryetarëve, për zhvillimin e raundit të dytë, asnjë kandidaturë për President nuk është depozituar në Kuvend.

Në këto kushte, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në zbatim të nenit 87, pika 2 të Kushtetutës, që përcakton se: ”Secili nga votimet e tjera zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga përfundimi pa sukses i votimit pararendës” dhe se “Votimi quhet i kryer edhe kur në konkurrim nuk paraqitet asnjë kandidat”, i paraqet seancës plenare të mbledhur në datë 23 maj 2022, sipas përcaktimeve ligjore, për informim raportin, me qëllim përmbylljen e procedurave për votimin e raundit të dytë për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Relator

EDUARD NDRECA

Kryetare

KLOTILDA BUSHKA (FERHATI)